



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 195, datë 29.12.2020**

**PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
KOMISIONERE, REGJISTRIMIN E DEGËS SË SHOQËRISË SË HUAJ  
KOMISIONERE DHE NJOHJEN E SHOQËRISË SË HUAJ KOMISIONERE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 14, nenit 16, nenit 27, nenit 35, nenit 39, dhe nenit 45, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e rregullores “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Titujve, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR  
DENIZ DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
ERVIN METE**